

## Komunat kamuflojnë të hyrat vjetore nga tatimi në prone



Koha Ditore  
Prishtinë, 13 dhjetor

Të dhënat që paraqesin komunat e Kosovës në lidhje me të hyrat vjetore nga tatimi në prone pothuajse në të gjitha rastet nuk paraqesin vlerën reale të pagesave që bëhen. Kështu ka deklaruar të enjten Mentor Rexhepi, zyrtar i lartë në projektin “Logos”, në konferencën “Tatimi në prone, praktikat, sfidat dhe zgjidhjet e mundshme”, që është mbajtur nën organizimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) dhe nga Ministria e Financave. Projekti “Logos” ka mbështetur komunat e Kosovës në rritjen e tatimit në prone.

“Në përgjithësi shumica e komunave raportojnë nivel të inkasimit të tatimit në prone (TP) prej rreth 80 apo 90 për qind, mirëpo realiteti është krejt ndryshe, pasi që një shumë e madhe e këtyre arkëtimit të raportuara vjetore të TP-së në komuna vjen nga pagesat e borxheve të vjetra, dënimeve dhe kamatave”, ka pohuar Rexhepi. Sipas tij, ka pasur raste kur disa komuna madje kanë raportuar të hyra nga tatimi në prone edhe mbi një qind për qind, mirëpo në realitet ato nuk arrijnë të inkasojnë as gjysmën e të hyrave nga faturat brenda një viti.

Rexhepi ka saktësuar se ky nivel i ulët i arkëtimit të këtij lloji tatimi gjatë një viti, krijon problem shumë serioz rreth mbledhjes së borxheve dhe kamatave nga tatimpaguesit. Ai madje ka thënë se ky problem me kohë do të bëhet edhe më i madh, pasi që borxhet do të rriten shumë, kurse komunat nuk do të mund as t'i falin e as t'i inkasojnë ato. Rexhepi ka përmendur se në shumicën e komunave vlera e pronave për metër katror dyshohet të jetë caktuar në mënyrë arbitrare, nën vlerën reale të tregut, e cila pastaj mbetet e njëjtë ndër vite, pavarësisht lëvizjes së çmimeve të patundshmërive në treg. Rexhepi ka pohuar se komunat nuk e kanë zbatuar Ligjin

për tatimin në pronë, i cili u lejon atyre edhe mbledhjen e detyrueshme dhe konfiskimin e pasurisë. Sipas tij, e vetmja masë e aplikuar për të vjelë këto të hyra të obligueshme është kushtëzimi i regjistrimit të automjeteve me pagesën e tatimit në pronë. Por, drejtues të komunave janë ankuar shumë edhe rreth kësaj mase, duke thënë se edhe zbatimi i saj është përcjellë me shumë problem (gjerësisht në “Kohën Ditore”).